

PËR TRANSPORTIN TOKËSOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME

Kuvendi i Republikës së KosovësNë mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Miraton

LIGJ PËR TRANSPORTIN TOKËSOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim rritjen e sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë dhe ose hekurudhë, ndihmesën efektive në mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës dhe mjedisit përmes parandalimit të çdo ndotje që mund të shkaktohet nga aksidentet ose incidentet gjatë këtij transporti, duke i ardhur në ndihmë biznesit që kryhen operacione të tilla transporti.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme brenda territorit të Republikës së Kosovës ose nga territori i një Pale Kontraktuese për në territorin e Republikës së Kosovës, ose nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese.
2. Ky ligj nuk zbatohet për operacionet e transportit, që kryhen:
 - 2.1. me mjete që i përkasin ose janë nën përgjegjësinë e forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës, si dhe forcave të armatosura të shteteve të tjetra në përputhje me marrëveshjen në fuqi;
 - 2.2. brenda perimetrit të një zone të mbyllur, ku mallrat mund të prodhohen, trajtohen, përpunohen, ruhen, sistemohen apo transferohen në hapësirën e brendshme.

3. Rregullat për transportin e mallrave të rrezikshme të Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës miratohen nga Ministri i ministrisë përkatëse të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Aksident** - fatkeqësi që si rezultat i ose gjatë të cilit, në rastin e transportit të mallrave të rrezikshme, përfundon me dëmtime në njerëz, të mira materiale ose mjedis;

1.2. **Ambalazh** - një ose më shumë enë, si kuti, fuçi, arka, shishe, bombola, cisterna, etj. dhe të gjithë elementët e tjerë ose materialet e nevojshme që këto enë të realizojnë funksionin e tyre mbajtës dhe të gjithë funksionet e tjera të sigurisë;

1.3. **Ambalazhues** - ndërmarrja e cila vendos mallrat e rrezikshme brenda në ambalazh duke përfshirë ambalazhimin e madh dhe në kontejnerë të ndërmjetëm të mallrave ose artikujve të ngurtë solide, në formë të granular dhe, ku është e nevojshme, parapërgatit paketat për transportim;

1.4. **Çertifikata e miratimit të mjetit sipas Marrëveshjes Europiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR)** - certifikata e miratimit të mjetit e lëshuar nga institucionet sipas nenit 38 të këtij ligji që një mjet i vetëm i destinuar për transportin e mallrave të rrezikshme plotëson kërkesat teknike përkatëse sipas paragrafit 1 të marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji;

1.5. **Çertifikatë trajnimi** - certifikata e lëshuar nga autoriteti përgjegjës te personi i cili ka kaluar një provim të miratuar nga autoriteti përgjegjës në transportin e mallrave të rrezikshme;

1.6. **Dërguesi i mallrave** - ndërmarrja e cila dërgon mallra të rrezikshme ose në emrin e pronarit të saj ose për një palë të tretë. Nëse operacioni i transportit kryhet sipas një kontrate për transportin, dërguesi nënkupton dërguesin në përputhje me kontratën për transportin;

1.7. **Dërgesë (ngarkesë)** - paketa ose paketat, ose ngarkesën e mallrave të rrezikshme, të paraqitura nga dërguesi për transport;

1.8. **Direktiva e mallrave të rrezikshme** - Direktiva Nr.2008/68/EC e Parlamentit Europian dhe të Këshillit e 24 Shtatorit 2008 “Mbi transportin tokësor të mallrave të rrezikshme” me amendime të herë pas hershme

1.9. **Ekuipazhi i mjetit** - ata persona të autorizuar nga operatori për të qëndruar në bordin e mjetit

1.10. **Incident** - fatkeqësi në përmasa të vogla e cila ndikon lidhur me operimin e mjeteve te transportit dhe që prek sigurinë e shfrytëzimit

1.11. **Inspektorët e kontrollit** - persona të autorizuar për kontrollin e transportit rrugor, respektivisht Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave për kontrollin e transportit hekurudhor

1.12. **Kontroll** - çdo kontroll, inspektim, verifikim ose formalitet të kryer nga organet përgjegjëse për arsye të sigurisë së qëndrueshme në transportin e mallrave të rrezikshme

1.13. **Këshilltar i sigurisë për transportin e mallrave të rrezikshme** - personi i caktuar roli i të cilit është për kryerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e funksioneve të përmendura në nenin 30 dhe i cili zotëron çertifikatën e trajnimit sipas nenit 29

1.14. **Mallra të rrezikshme** - mallrat, lëndët, artikujt dhe materialet që ndodhen në dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji, të ndarë në klasat: eksplozivë, gazra, lëngje të ndezshme, materialet e rrezikshme në gjendje të ngurtë, substancat vetë-reaktive dhe eksplozivët e ngurtë të pandjeshëm, substancat që vetëndizen spontanisht, substancat që në kontakt me ujin emetojnë gaze të djegshme, substancat oksiduese, peroksidet organike, helmet, substancat infektive, materialet radioaktive, substancat korrozive dhe substancat e tjera të rrezikshme. Materialet e rrezikshme dhe mbeturinat e pranishme të materialeve radioaktive dhe bërthamore, nëse ato plotësojnë kushtet për klasifikim si mallra të rrezikshme në bazë të dispozitave të marrëveshjes të përmendur në nenin 5 të këtij ligji

1.15. **Marrësi i mallrave** - marrësi në përputhje me kontratën për transportin. Nëse marrësi cakton një palë të tretë në përputhje me dispozitat e aplikueshme në kontratën për transportin, ky person gjykohet si marrës brenda kuptimit të marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji. Nëse operacioni i transportit kryhet pa një kontratë për transportin, ndërmarrja e cila merr përgjegjësinë për mallrat e rrezikshme në mbërritje konsiderohet si marrësi i mallrave

1.16. **Mbushës** - ndërmarrja e cila ngarkon mallra të rrezikshme në (mjet-cisternë ose vagon - cisternë, cisternë të çmontueshme, cisternë të lëvizshme ose kontejner-cisternë) dhe, ose brenda në mjet, në kontejner të madh ose të vogël për transportin e mallrave të ngurta, në formë të granuluar ose pluhur;

1.17. **Ministria** - Ministria, që mbulon çështjet e transportit

1.18. **Ministri** - Ministri përgjegjës për çështjet e transportit

1.19. **Mjet** - çdo mjet brenda kuptimit të nenit 5 të këtij ligji (një mjet motorik ose rimorkio, mjet hekurudhor)

1.20. **Ngarkues** - ndërmarrje e cila ngarkon mallrat e rrezikshme në mjet ose në një kontejner të gjerë

1.21. **Paketa** - produkti i përfunduar i operacionit të ambalazhimit i përgatitur për dërgim, i përbërë nga ambalazhi, ose ambalazhi i madh ose kontejner i ndërmjetëm për substanca solide dhe përmbajtjen e vetë të saj. Termi përfshin bombolat e gazit siç janë të përkufizuar po kështu dhe artikuj që për nga madhësia pesha apo konfigurimi, mund të transportohen të paambalazuara në mbajtëse, arka ose pajisje trajtimi. Me përjashtim të transportit të materialeve radioaktive, termi nuk aplikohet për mallrat e ngurta të transportuara në sasi të mëdha e as për substancat e transportuara në cisternë

1.22. **Pjesëmarrës** - ndërmarrje e përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme dhe i lidhur me veprimtarinë e ngarkimit, shkarkimit, paketimit dhe mbushjes dhe përfshin dërguesin, transportuesin, marrësin, ngarkuesin, paketuesin, mbushësin, dhe operatorin e cisternës – lëvizshme ose cisternës – kontejner

1.23. **Transport** - operacioni i transportit, të kryer me anë të një mjeti, plotësisht ose pjesërisht, në rrugët publike, ose me hekurudhë, dhe përshinë veprimtaritë e ngarkimit, shkarkimit e ambalazhimit dhe mbushjes

1.24. **Transporti tokësor i mallrave të rrezikshme** - transporti i mallrave të rrezikshme me rrugë ose me hekurudhë

1.25. **Transportues** – subjekti i cili kryhen operacione transporti me ose pa kontratë transporti

1.26. **ADR** - Marrëveshja Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme

1.27. **CIM** - Konventa ndërkombëtare për transportin e mallrave me hekurudhë

1.28. **COTIF** - Konventa për transportin ndërkombëtar hekurudhor,

1.29. **RID** - Rregullat në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme me hekurudhë - Aneksi C

1.30. **Numri i UN** – një numër identifikues katërshifror i një substance apo i një artikulli të marrë nga Projektregullorja e Kombeve të Bashkuara.

2. Një term ose shprehje e përdorur në këtë ligj, e cila përdoret, gjithashtu, në marrëveshjet e nenit 5 të këtij ligji, ka të njëjtin kuptim me ato të përdorura në këto marrëveshje, për aq sa të mos ketë kuptim të kundërt.

3. Termat apo shprehjet të përdorura në këtë ligj kanë kuptim të njëjtë siç përdoren në marrëveshjet e përmendura në nenin 5 të këtij ligji.

4. Aplikohen edhe përkufizimet e dhëna në kapitullin 1.2 të ADR dhe të RID.

Neni 4

Objekti i ligjit

1. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e:

1.1. proceduarave mbi të cilat duhet të kryhet transporti tokësor i mallrave të rrezikshme

1.2. detyrimeve të pjesëmarrësve të përfshirë në këtë lloj transporti, dërguesin, transportuesin, marrësin e ngarkesës, ambalazhuesin, përgatitësin e paketave për transport, ngarkuesin, mbushësin e shkarkuesin

1.3. kushteve të trajnimit dhe testimit për ambalazhuesin, përgatitësin e paketave për transport, ngarkuesin, mbushësin, shkarkuesin

1.4. proceduarave për emërimin e këshilltarëve të sigurisë dhe trajnimin e testimin e tyre

1.5. kushteve që duhet të plotësojnë mjetet e transportit të përfshirë në këtë lloj transporti dhe drejtuesit e këtyre mjeteve

1.6. kompetencave të institucioneve përkatëse publike në lidhje me transportin dhe mbikëqyrjen në zbatimin e këtij ligji.

Neni 5

Marrëveshjet ndërkombëtare

1. Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme zbatohet “Marrëveshja Europiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR)” dhe Protokollin e Nënshkrimit”, përfunduar në Gjenevë, më 30 Shtator 1957, me pjesët e saj përbërëse, Anekset A dhe B.

2. Për transportin ndërkombëtar hekurudhor të mallrave të rrezikshme zbatohet në Konventën ndërkombëtare për transportin e mallrave me hekurudhë (CIM) dhe në Konventën për transportin ndërkombëtar hekurudhor (COTIF), Aneksi C – “Rregullat në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme me hekurudhë (RID)”.

3. Për transportin e substancave radioaktive dhe materialeve bërthamore zbatohet:

3.1. Ligji për mbrojtje nga rrezatimi jojonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare dhe Ligji për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Neni 6

Transporti me shtete Palë Kontraktuese

Transporti i mallrave të rrezikshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe një shteti i cili është palë kontraktuese në marrëveshjet sipas paragrafit 1. dhe 2. të nenit 5 të këtij ligji, lejohet për aq sa ky transport përputhet me dispozitat e marrëveshjes të përmendur në këtë nen.

KREU II

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME TRANSPORTIN TOKËSOR

Neni 7

Kriteret bazë për realizimin e të drejtës së licencës

1. Kriteret bazë për marrjen e licencës në përputhje me legjislacionin e BE-së janë:

1.1. Kompetenca profesionale

1.2. Reputacioni i mirë

1.3. Besueshmëria financiare

1.4. Përmbushja e standardeve teknike.

2. Rregullat e detajuara për kriteret bazë për marrjen e licencës nga subjektet që kërkojnë të marrin licencën për transportin e mallrave të rrezikshme, përcaktohen nga Ministria me akt nënligjor.

Neni 8

Ambalazhet e lejuara

1. Për transportin e mallrave të rrezikshme lejohen vetëm ambalazhet:

1.1. që nga cilësia, përbërja dhe forma janë në përputhje me sasinë dhe specifikat që i përgjigjen mallrave të rrezikshme që mbarten gjatë transportimit

1.2. të cilët janë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji për transportin e lejuar të mallrave të rrezikshme

1.3. të cilët janë të kontrolluar dhe të miratuar në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji

1.4. të cilët kanë shenja paralajmëruese dhe etiketa, që tregojnë rrezikun, dhe të dhëna të tjera për mallrat e rrezikshme dhe ambalazhit në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 9

Miratimi i ambalazhit

1. Një prodhues ambalazhi për mallrat e rrezikshme është i detyruar të merr miratimin për llojin e ambalazhit.

2. Prodhuesi i ambalazhit është i detyruar të vendos shenjat e miratimit të tipit në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.

3. Prodhuesi i ambalazhit për mallrat e rrezikshme nuk vendos shenja për të treguar miratimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëse ambalazhi nuk është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5, të këtij ligji.

Neni 10

Çertifikimi i cisternave dhe llojeve të tjera të ambalazhit

1. Çertifikata, raportet e testimiit dhe të inspektimit për ambalazhet që do të përdoren për transportin e materialeve radioaktive lëshohet nga Agjensioni për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria nukleare e Republikës së Kosovës.
2. Çertifikata, raportet e testimiit dhe të inspektimit për ambalazhet që do të përdoren për transportin e materialeve bërthamore lëshohet nga organi i autorizuar Agjensioni për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria nukleare e Republikës së Kosovës.
3. Raportet e shqyrtimeve dhe kontrolleve teknike për ambalazhet që konsiderohen apo shqyrtohen si pajisje nën presion e që do të përdoren për transportin e lëndëve djegëse të lëngshme dhe gazeve, cisternave ose cisternave fikse me automjetin, lëshohet nga organi përkatës inspektues i autorizuar nga Inspektorati për paisje nën presion në minsitrinë përkatëse. Në bazë të raportit të këtij organi inspekutes lëshohet certifikata për plotësimin e kërkesave të sigurisë teknike të ambalazheve të lartpërmendura.
4. Çertifikatat, raportet e testimiit dhe të inspektimit për ambalazhet që do të përdoren për transportin e substancave të rrezikshme të tjera nga ato të përmendura në paragrafin 1., 2. dhe 3. të këtij neni lëshohet nga organi i autorizuar nga ministri përgjegjës.
5. Kërkesës për dhënien e të drejtës personit juridik sipas paragrafit 4. të këtij neni i bashkëngjitet kompetenca profesionale për përfitimn e të drejtës së procedurës për dhënien e certifikatës, raportet e testimiit dhe të inspektimit, për ambalazhet që përdoren për transportin e mallrave të rrezikshme.
6. Institucionet dhe personat juridikë të autorizuar të përmendur në paragrafin 1, 2., 3. dhe 4. të këtij neni lëshojnë certifikata, raporte testimi e inspektimi për ambalazhin që përdoret, vetëm, kur është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 5 të këtij ligji.
7. Institucionet dhe personat juridikë të autorizuar të përmendur në paragrafin 1., 2., 3. dhe 4. të këtij neni, mund të marrin si bazë për dhënien e certifikatës, raportet e testimiit dhe të inspektimit për ambalazhin që do të përdoret, nga një person juridik i huaj me seli në një shtet tjetër, i cili plotëson kushtet sipas nenit 5 të këtij ligji, nëse kjo është në interesin e përbashkët, të thjeshtësisë, të efikasitetit ekonomik dhe të shpejtësisë së procesit.
8. Ambalazhi i cili është i miratuar nga autoriteti përgjegjës i shtetit njihet, vetëm, nëse është testuar dhe miratuar në përputhje me dispozitat e marrëveshjes të përmendur në nenin 5 të këtij ligji.
9. Qeveria me vendim përcakton kushtet e rregullat për dhënien dhe heqjen e autorizimit për ambalazhet nga institucionet e ministrive përkatëse të përmendur në paragrafin 1., 2., 3. dhe 4. të këtij neni.

Neni 11

Shënimet e ambalazhit

1. Institucionet dhe personat e autorizuar juridikë të përmendur në paragrafin 1., 2., 3. dhe 4. të nenit 10 të këtij ligji ose organet e autorizuar prej tyre miratojnë ambalazhin me mënyrën e shënimit të përcaktuar në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në

nenin 5 të këtij ligji. Nuk lejohet përdorimi i shenjave të cilat mund të shkaktojnë keqkuptime me shenjat e miratuara më parë ose me shenjat e vendeve të tjera.

2. Nëse për arsye të sigurisë në transport është e domosdoshme, apo nëse është caktuar me dispozita në marrëveshjen e nenit 5 të këtij ligji, në/mbi ambalazhe lejohen të vendosen shënime me kufizimet e nevojshme në lidhje me përdorimin e ambalazhit (kushtet e veçanta, kufizimet kohore, etj).

Neni 12

Heqja e certifikatës së ambalazhit

1. Në qoftë se organet e kontrollit, konstatojnë se ambalazhi nuk është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 5 të këtij ligji, ata ndalojnë përdorimin e tij për transportin e mallrave të rrezikshme dhe njoftojnë menjëherë institucionet ose personat juridikë të autorizuar në paragrafin 1., 2., 3. dhe 4. të nenit 10 të këtij ligji.

2. Institucionet ose personat juridikë të autorizuar në paragrafin 1., 2., 3. dhe 4. të nenit 10 të këtij ligji do të fillojnë menjëherë procedurat për heqjen autorizimit për ambalazhin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 13

Kushtet që duhet të plotësojnë mjetet

1. Për transportin e mallrave të rrezikshme përdoret një mjet që:

1.1. është i prodhuar dhe është i pajisur në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji

1.2. ka një certifikatë të vlefshme të miratimit për transportin e mallrave të rrezikshme, të caktuar, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji

1.3. është i pajisur me panele (pllakata) dhe është i shënuar në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 14

Detyrimet e pjesëmarrësve për rritjen e sigurisë dhe raportimi i ngjarjeve që përfshijnë mallrat e rrezikshme

1. Të gjithë pjesëmarrësit në transportin tokësor të mallrave të rrezikshme marrin të gjitha masat e nevojshme, në përputhje me natyrën dhe shtrirjen e parashikuar të rreziqeve, për reduktimin ose shmangien e dëmeve në njerëz, në pronë dhe në mjedis. Ata zbatojnë, në të gjithë rastet, kërkesat e marrëveshjes të nenit 5 të këtij ligji në fushat e tyre respektive.

2. Në rastin e një rreziku serioz ose aksidenti të menjëhershëm, ku siguria e publikut dhe e pronës mund të rrezikohet, pjesëmarrësit në transportin e mallrave të rrezikshme njoftojnë menjëherë Qendrën për Alarmim dhe Koordinim Emergjent të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent 112, duke venë në dispozicion të saj të gjithë informacionin e nevojshëm për ndërmarrjen e veprimeve.

3. Në rastin e një aksidenti serioz ose incidenti gjatë veprimtarisë së ngarkimit, mbushjes, transportit ose shkarkimit të mallrave të rrezikshme, ngarkuesi, mbushësi, transportuesi ose marrësi, respektivisht për fushën që mbulojnë do të përgatisin një raport për aksidentin në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 dhe ia paraqesin Ministrit. Forma dhe përmbajtja e modelit të raportit caktohet me akt nënligjor të Ministrisë.

4. Dërguesi, transportuesi dhe marrësi bashkëpunojnë me njëri tjetrin dhe me personat e autorizuar të autoriteteve shtetërore në shkëmbimin e informacionit, me qëllim rritjen e sigurisë, për masat parandaluese dhe procedurat që duhet të ndiqen në rastin e aksidenteve dhe incidenteve.

Neni 15

Detyrimet e dërguesit

1. Dërguesi i mallrave të rrezikshme është personi juridik ose fizik, i cili është i emëruar ose është i identifikuar në dokumentacionin e transportit si dërgues i mallrave.

2. Dërguesi dorëzon mallra të rrezikshme për transport, vetëm nëse:

2.1. janë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji
2.2. janë të pajisur me autorizim për transportin e mallrave të rrezikshme, për të cilat kërkohet një autorizim i tillë në përputhje me nenin 24 të këtij ligji
2.3. janë të vendosur në ambalazh që i përmbush kërkesat e nenit 8 të këtij ligji
2.4. janë në përputhje të plotë me kushtet e transportit, ngarkimit të përbashkët (përzier), trajtimit, ruajtjes, pastrimit dhe dekontaminimit, si dhe dispozitat e tjera në bazë të marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji
2.5. mjetet janë në përputhje me kërkesat e nenit 13 të këtij ligji
2.6. drejtuesi i mjetit apo personi juridikë ose fizikë, i cili kryhen transportin, janë të pajisur me dokumentet e nevojshme shoqëruese të paraqitura në bazë të dispozitave të përmendur në marrëveshjet e nenit 5 të këtij ligji dhe, nëse është e nevojshme, autorizimin për transport në përputhje me nenin 24 të këtij ligji
2.7. zbaton masa të tjera sigurie në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.

3. Kur dërguesi përdor shërbime të pjesëmarrësve të tjerë (paketuesin, ngarkuesin, mbushësin, etj.), ai merr masa të përshtatshme për të garantuar që dërgesa plotëson dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji. Ai gjithashtu, mbështet në informacionin dhe të dhënat që i dërgojnë pjesëmarrësit e tjerë në transport.

4. Kur dërguesi vepron në emër të një pale të tretë, kjo e fundit informon dërguesin me shkrim për mallrat e rrezikshme, të cilat janë përfshirë, dhe i dërgon atij të gjithë informacionin dhe dokumentet e nevojshme për kryerjen e detyrimeve të tij.

Neni 16

Detyrimet e transportuesit

1. Transportuesi transporton mallra të rrezikshme vetëm nëse:

1.1. mallrat e rrezikshme që do të transportoj janë të lejuara për transport në bazë të marrëveshjes në nenin 5, të këtij ligji, si dhe janë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës, i cili ndodhet në mjetin e transportit

1.2. është i pajisur me një autorizim për transportin e mallrave të rrezikshme, për të cilat kërkohet autorizimi sipas nenit 24 të këtij ligji

1.3. mallrat e rrezikshme janë të paketuar në ambalazhe që i plotësojnë kërkesat e nenit 8 të këtij ligji, si dhe janë vendosur etiketat e rrezikshmërisë dhe shënimet e përshkruese për mjetet ose vagonët

1.4. janë përmbushur kushtet për mënyrën e transportit, ngarkimin e përbashkët, trajtimin dhe sigurimin e mallrave të rrezikshme, dhe pastrimin dhe dekontaminimin e enëve ku vendosen mallrat dhe dispozitat e tjera në bazë të marrëveshjes të nenit 5 të këtij ligji

1.5. mjeti përmbush kërkesat e nenit 13 të këtij ligji dhe është teknikisht në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji

1.6. mjeti është i ngarkuar siç duhet dhe në përputhje me nivelet maksimale të lejuara për mallrat e rrezikshme, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5, të këtij ligji

1.7. mjeti është i pajisur me dokumentin e sigurimit të përgjegjësisë për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë fushë

1.8. respekton masa të tjera të sigurisë, në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve në nenin 5, të këtij ligji dhe me rregullat e tjera që rregullojnë sigurinë në transport.

2. Transportuesi, për rastin e caktuar në nënparagrafin 1.1., 1.3. dhe 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni, mbështet me informacionin e të dhënave nga pjesëmarrësit e tjerë.

3. Nëse transportuesi vëzhgon një shkelje të kërkesave të dispozitave të marrëveshjes sipas nenit 5 të këtij ligji, ai nuk e nis ngarkesën deri sa çështja të sqarohet.

Neni 17

Detyrimet e marrësit

1. Marrësi i ngarkesës ka për detyrë të pranoj sa më shpejtë mallrat dhe të verifikoj, pas shkarkimit, që kërkesat sipas dispozitave të marrëveshjes në nenin 5, të këtij ligji janë plotësuar.

2. Marrësi i ngarkesës, në veçanti, duhet:

2.1. të kryej pastrimin e përshkruar dhe dekontaminimin e mjeteve dhe kontejnerëve siç parashikohet në dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji

2.2. të heq nga kontejnerët e shkarkuar, të pastruar dhe të dekontaminuar, plotësisht, panelet dhe shenjat që tregojnë rrezikun siç përcaktohet në dispozitat e marrëveshjes të nenit 5 të këtij ligji

2.3. shkarkon mallrat e rrezikshme në vendet përkatëse të caktuara për shkarkim.

3. Nëse marrësi i ngarkesës përdor shërbime të pjesëmarrësve të tjerë, si shkarkues, pastrues, dekontaminues etj, ai merr masa të përshtatshme që garantojnë plotësimin e kërkesave sipas dispozitave të marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.

4. Nëse nga verifikimet konstatohet një shkelje e kërkesave sipas dispozitave të marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji, marrësi kthen kontejnerin te transportuesi vetëm pasi shkelja është evituar.

Neni 18

Detyrimet e ngarkuesit

1. Ngarkuesi në veçanti kryhen detyrime si vijon:

1.1. dorëzon mallra të rrezikshme te transportuesi vetëm nëse ato janë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji. 1.2. kontrollon gjatë dorëzimit mallrat e rrezikshme të paketuara ose ambalazhet bosh të papastruara, kontrollon nëse ambalazhi është dëmtuar. Ai nuk dorëzon paketën, ambalazhi i të cilës është dëmtuar, veçanërisht nëse nuk ka kryer provën e rrjedhjes, dhe ka rrjedhje ose ka mundësi rrjedhjeje të substancës së rrezikshme, deri sa dëmtimi të jetë riparuar, ky detyrim gjithashtu zbatohet te ambalazhet e papastruara bosh. 1.3. përputh kërkesat speciale në lidhje me ngarkimin ose trajtimin, kur ngarkon mallrat e rrezikshme në një mjet, ose në një kontejner. 1.4. plotëson kërkesat në lidhje me shenjat e rrezikut, si pllakatet ose pllakën portokalli mbi mjet ose mbi kontejner sipas dispozitave të nenit 5 të këtij ligji. 1.5. zbaton ndalimet mbi ngarkesat e përziëra duke marrë parasysh mallrat e rrezikshme në mjet ose në kontejner, dhe zbaton kërkesat në lidhje me ndarjen e ushqimeve, ose artikujve të tjerë të konsumit ose ushqimet e kafshëve. 1.6. përputh masat e tjera të sigurisë me dispozitat e nenit 5 të këtij ligji.

Neni 19

Detyrimet e ambalazhuesit

1. Detyrimet e përgatitësit të paketave në veçanti janë:

1.1. plotësimi i kërkesave në lidhje me kushtet e ambalazhimit, ose kushteve të ambalazhimit të paketave të përziëra. 1.2. plotësimi i kushteve në lidhje me shenjat paralajmëruese dhe etiketat e paketave. 1.3. respektimi i masave të tjera të sigurisë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së nenit 5 të këtij ligji.

Neni 20

Detyrimet e mbushësit

1. Mbushësi, në veçanti, kryhen detyrimet si vijon:

1.1. para fillimit të mbushjes me substanca të rrezikshme, ai kontrollon për të gjithë llojet e cisternave e pajisjet e tyre, nëse janë teknikisht të rregullta, dhe sigurohet që afati i fundit për testin (inspektimin) e ardhshëm për të gjithë llojet e cisternave nuk ka kaluar.
1.2. mbush vetëm cisternat me mallra të rrezikshme të autorizuara për transportim në ato cisterna.
1.3. gjatë mbushjes së cisternës, plotëson kërkesat në lidhje me mallrat e rrezikshme në ndarjet (komorat) që janë ngjitur me njëra-tjetrën (fqinjë);

1.4. gjatë mbushjes së cisternës, vëzhgon nivelin e lejuar maksimal të mbushjes ose masën e lejuar maksimale të përmbajtjes për litër të kapacitetit për substancën që është duke u mbushur.
1.5. kontrollon, pas mbushjes, pajisjet e shkarkimit të cisternës për izolim ndaj rrjedhjes.
1.6. sigurohet që nuk ka mbetje të substancës, që mbushi në sipërfaqen e jashtme të cisternës të mbushur prej tij.
1.7. sigurohet që pllaka ngjyrë portokalli dhe panelet ose etiketat janë të fiksuara në cisternë, mbi mjet e kontejner.
1.8. gjatë mbushjes së mjeteve ose kontejnerëve me mallra të ngurta, të granular e që vepron në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.
1.9. zbaton masa të tjera të sigurisë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 21

Detyrimet e operatorit të cisternës – kontejner ose cisternës së lëvizshme

1. Operatori i cisternës kontejner ose i cisternës së lëvizshme në veçanti duhet:

1.1. të garantojë plotësimin e kërkesave për konstruksionin, pajisjen, testimin dhe shenjëzimin e cisternës kontejner ose të cisternës së lëvizshme në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.
1.2. të sigurojë mirëmbajtje të cisternave dhe pajisjeve të tyre për të garantuar përputhjen me nënparagrafin 1.1. të këtij neni deri në kohën e inspektimit teknik pasues.
1.3. të sigurojë një inspektim teknik jashtë radhe (të veçantë) të sigurisë së cisternës për të garantuar përputhjen me nënparagrafin 1.1. të këtij neni në rastin e ndonjë dobësimi nga një riparim, ose nga një ndryshim ose nga një aksident, të cilat ndikojnë në sigurinë e tyre.
1.4. të zbatojë masa të tjera të sigurisë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.

Neni 22

Detyrimet e transportuesit në rast humbje të mallit

1. Transportuesi duhet të marrë të gjithë masat e duhura me qëllim shmangien për humbjen e pjesshme ose të gjithë mallrave të rrezikshme gjatë transportit. Në rast konstatimi, ai duhet të informoj menjëherë Qendrën për Alarmim dhe Koordinim Emergjent të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent

112, për llojin dhe sasinë e mallrave të rrezikshme, si dhe shkallën e rrezikut që ato paraqesin për dëmtimin e njerëzve, pronës dhe mjedisit.

2. Një ngjarje që ka ndodhur sipas paragrafit 1. të këtij neni është subjekt i një raporti sipas paragrafit 3, të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 23

Masat që merren në rast derdhje apo rrjedhje të mallrave të rrezikshme

1. Në rast derdhje apo rrjedhje të mallrave të rrezikshme, transportuesi merr masat e nevojshme duke i mbledhur apo duke i hequr, ose duke i vendosur në një vend të caktuar, ose duke i bërë ato të padëmshme, dhe duhet të njoftoj menjëherë Qendrën për Alarmim dhe Koordinim Emergjent të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent 112.
2. Nëse transportuesi nuk është në gjendje të përmbush vetë detyrimet e vendosura në paragrafin 1. të këtij neni, ai mund të përdor për këto shërbime, pjesëmarrës të tjerë të autorizuar për të vepruar në raste të tilla.
3. Artikujt e mallrave të rrezikshme të derdhur ose që kanë rrjedhur ose objekte të kontaminuar duhet të neutralizohen me rregullore të veçanta.
4. Një ngjarje që ka ndodhur sipas paragrafit 1. të këtij neni është subjekt i raportit sipas paragrafit 3. të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 24

Transportet e kryera me autorizim

1. Për transportin e mallrave të rrezikshme, si lëndët plasëse (eksplozivët), lëndët radioaktive e materialet bërthamore kërkohet autorizim.
2. Autorizimi për transportin e eksplozivëve lëshohet nga Ministria e Brendshme dhe njëkohësisht me lëshimin e këtij autorizimi kryhet njoftimi për organet e policisë përmes të cilave itinerari i udhëtimit kalon.
3. Autorizimi për transportin e materialeve radioaktive lëshohet nga Agjensioni për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore e Republikës së Kosovës.
4. Autorizimi për transportin e materialeve bërthamore lëshohet nga Agjensioni për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore e Republikës së Kosovës.
5. Si përjashtim nga paragrafi 2., 3. dhe 4., të këtij neni, autorizimi për transportin e brendshëm për substancat eksplozive dhe materialet bërthamore e radioaktive, nuk është i nevojshëm vetëm në rastin kur kryhet në përputhje me përjashtimet e parashikuara në dispozitat e marrëveshjes të nenit 5 të këtij ligji. Për substancat eksplozive, transportuesi informon Organet Policore të Republikës së Kosovës, njëzet e katër (24) orë para se të kalon dhe përfundon udhëtimi. Informacioni shoqërohet me kohën e saktë të fillimit dhe kohën e përafërt të parashikuar, të përfundimit të operacionit të transportit.
6. Personit juridik apo fizik, veprimtaria e të cilit është e lidhur me përdorimin e substancave eksplozive ose radioaktive, mund t'i jepet autorizim për një transport të shumëfishtë të këtyre substancave, i vlefshëm për një muaj për substancat eksplozive

dhe deri në gjashtë (6) muaj për substancat radioaktive. Një autorizim i tillë jepet vetëm nëse plotësohet kushti që transporti të kryhet në të njëjtën ditë të javës, në të njëjtën orë, në të njëjtin itinerar nga origjina në destinacion dhe me të njëjtin mjet/mjete transporti.

7. Personi, i cili aplikon për një autorizim sipas këtij neni, duhet të njoftojë, për kohën e saktë të fillimit dhe kohën e përafërt të parashikuar, të përfundimit të transportit të paktën njëzet e katër (24) orë para transportimit, drejtorinë e policisë në rrethin nga i cili transporti i substancave eksplozive fillon, ose organet e policisë kufitare të pikës ku kryhet kalimi, në të cilën është importuar, eksportuar apo transportuar substanca eksplozive, ndërsa në rastin e transportit të substancave radioaktive dhe materialeve bërthamore edhe institucionin që ka lëshuar autorizimin.

Neni 25

Kërkesa për autorizim

1. Kërkesa për autorizim për transportin e mallrave në përputhje me paragrafin 1. të nenit 24 të këtij ligji, paraqitet nga dërguesi ose transportuesi ose marrësi, dhe përmban elementët e mëposhtëm:

1.1. informacion rreth prodhuesit, dërguesit ose transportuesit ose marrësit të ngarkesës
1.2. numrin e UN të mallrave të rrezikshme dhe të dhënat që konfirmojnë dispozita të caktuara të marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji;

1.3. llojin e të dhënave, si emrin, sasinë, mënyrën e paketimit dhe përbërjen kimike dhe fizike të mallrave të rrezikshme
1.4. hartën me itinerarin e lëvizjes
1.5. treguesin e vendit të shkarkimit
1.6. një periudhë prej pesëmbdhjetë (15) ditë, brenda të cilës kryhet transporti
1.7. një informacion rreth automjetit dhe drejtuesit të transportit të mallrave me rrugë
1.8. miratimin e autoriteteve përgjegjëse të shtetit fqinjë i cili lejon importimin ose transitimin.

2. Kur aplikohet për autorizimin e posaçëm për transportin e shumëfishtë sipas paragrafit 6. të nenit

24, të këtij ligji nuk është e nevojshme të jepen specifikimet në nënparagrafin 1.7. dhe 1.8., të paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 26

Kërkesa sigurie shtesë për lëshimin e një autorizimi

1. Organi përgjegjës për lëshimin e autorizimit mund të vendos kushte shtesë për transportin ose masa sigurie të posaçme, për mbrojtjen e njerëzve, mjedisit, pronës, ose për të mbrojtur transportin nga persona të paautorizuar.

2. Shpenzimet për kushtet shtesë ose masat e veçanta mbulohen nga personi fizik ose juridik që ka aplikuar për autorizim.

Neni 27

Kufizimet

1. Organi përgjegjës për lëshimin e autorizimit për transportin e mallrave të rrezikshme, të caktuara mund të ndaloj transportin e këtyre mallrave të rrezikshme të caktuar, apo lejoj transportin vetëm në kushte të veçanta, nëse kjo është e nevojshme për arsye të sigurisë në transport, rendin publik apo mbrojtjen e njerëzve dhe mjedisin.
2. Organi përgjegjës në çdo rast njofton ministrinë para nisjes së procedurave të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 28

Ndalimi i etiketimit të paketave dhe automjeteve

Ndalohet shënimi mbi paketat ose mbi mjetet, që nuk kryejnë transport të mallrave të rrezikshme me pllakate, shenja paralajmëruese, etiketa, që përdoren për të treguar rrezikshmërinë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes të përmendur në nenin 5 të këtij ligji.

KREU III

KËSHILLTARI I SIGURISË DHE PJESËMARRËSIT QË PËRFSHIHEN NË TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME ME RRUGË DHE ME HEKURUDHË

Neni 29

Këshilltari i Sigurisë

1. Ndërmarrja, e cila në veprimtarinë e saj, përfshin transportin, ose veprimtaritë e lidhura me ambalazhimin (paketimin), ngarkimin, mbushjen ose shkarkimin, e mallrave të rrezikshme me rrugë dhe, ose me hekurudhë cakton zyrtarisht një ose më shumë këshilltarë të sigurisë për transportin e mallrave të rrezikshme, i cili, është i ngarkuar që të ndihmojë në parandalimin e rreziqeve të qenësishme në veprimtari të tilla ndaj njerëzve, pronës dhe mjedisit.
2. Ndërmarrja e përmendur në paragrafin 1. të këtij neni njofton, brenda pesëmbdhjetë (15) ditëve kalendarike nga data e caktimit, ministrinë për identitetin e këshilltarit të sigurisë, si dhe informon për çdo ndryshim të mundshëm që ka lidhje me këtë person.
3. Ndërmarrja nuk cakton këshilltar të sigurisë, të kërkuar në paragrafin 1. të këtij neni, po qe se ky person nuk është mbajtës i një certifikate të vlefshme, të kualifikimit profesional të tij.
4. Këshilltari i sigurisë mund të jetë drejtues i ndërmarrjes, një person me detyrime të tjera në ndërmarrje, ose një person i punësuar me kohë të pjesshme nga ndërmarrja, me kusht që ky person të jetë i aftë në kryerjen e detyrimeve të këshilltarit.

5. Ministria nxjerr akt nënligjor dhe përcakton rregullat për njohjen e certifikatave të lëshuara nga organet e caktuara të një Shteti tjetër, palë Kontraktuese në marrëveshjen e nenit 5 të këtij ligji.

6. Ndërmarrjet, të cilat kryejnë transport të mallrave të rrezikshme, të përjashtuara nga dispozita të caktuara të marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji, nuk kanë detyrim të caktojnë këshilltar të sigurisë.

Neni 30

Detyrat e këshilltarit të sigurisë

1. Detyra kryesore e këshilltarit të sigurisë është, nën përgjegjësinë e drejtuesit të ndërmarrjes, që të mundësoj, me të gjithë mjetet e përshtatshme dhe me të gjithë veprimet e duhura, lehtësimin në administrimin e veprimtarive të caktuara si dhe në përputhje me kërkesat e zbatueshme e mënyrën më të sigurt të mundshme, të shprehura në dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.

2. Detyrat e këshilltarit të sigurisë në lidhje me veprimtarinë e ndërmarrjes kryesisht janë:

2.1. monitorimi për respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë transportin e mallrave të rrezikshme

2.2. këshillimi i ndërmarrjes së tij mbi transportin e mallrave të rrezikshme

2.3. përgatitja e një raporti vjetor sipas udhëzimeve të minsitrisë për ndërmarrjen për transportin e mallrave të rrezikshme. Raportin ia dërgon ministrisë brenda 3 mujorit të parë të vitit pasardhës. Raporti ruhet për pesë (5) vjet në ndërmarrje dhe do të jetë i disponueshëm për ministrinë e institucionet e tjera të interesuara të ngarkuara me ligj sa herë kërkohen prej tyre

2.4. këshillimi i punonjësve të tjerë të ndërmarrjes dhe mirëmbajtja e dosjeve për këshillimin e tyre

2.5. zbatimi i masave të përshtatshme për mënjanimin e përsëritjes së një aksidenti, incidenti ose shkeljeve serioze

2.6. zbatimi i masave të duhura në rastin e ndonjë aksidenti, incidenti që mund të ndikojnë në sigurinë gjatë transportit, ngarkimit ose shkarkimit të mallrave të rrezikshme

2.7. kontrolli që lejon verifikimin e pajisjeve të përdorura në lidhje me transportin, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave të rrezikshme

2.8. zbatimi i procedurave të verifikimit me qëllim që në bordin e mjeteve të transportit të jenë dokumentet dhe pajisjet e sigurisë që duhet të shoqërojnë transportin dhe që këto dokumente e pajisje të jenë në përputhje me rregullat.

3. Detyrat e këshilltarit të sigurisë, gjithashtu përshijnë monitorimin e praktikave dhe procedurave në lidhje me veprimtarinë përkatëse të ndërmarrjes në përputhje me dispozita të caktuara në marrëveshjen e nenit 5 të këtij ligji.

Neni 31

Raportet në rastin e aksidenteve

1. Kur ndodh aksident me pasojë dëme në persona, pronë ose mjedis gjatë transportit, ngarkimit, ose shkarkimit të kryera nga ndërmarrja, këshilltari i sigurisë, pas mbledhjes së informacionit, përgatit një raport dhe dorëzon një kopje të tij në ndërmarrjen ku ka ndodhur aksidenti.
2. Raporti i aksidentit i përgatitur sipas paragrafit 1. të këtij neni do të ruhet në ndërmarrje për pesë (5) vjet dhe është i vlefshëm për ministrinë, për personat e autorizuar për kontroll sipas nenit 40 të këtij ligji e institucionet e tjera të ngarkuara me ligj sa herë kërkohen prej tyre.
3. Raporti i aksidentit nuk zëvendësohet me një raport tjetër, i cili mund të ketë lidhje me menaxhimin e ndërmarrjes, dhe që kërkohet nga legjislacioni kombëtar ose ai ndërkombëtar.

Neni 32

Trajnimi profesional i këshilltarit të sigurisë

1. Ministria, në përputhje me marrëveshjet e përmendura në nenin 5 të këtij ligji, përcakton, me akt nënligjor programin e edukimit, zbatimin, mënyrën e trajnimit dhe mënyrën e vlerësimit të këshilltarëve të sigurisë.
2. Ministria, në përputhje me marrëveshjet e përmendura në nenin 5 të këtij ligji, përcakton, me akt nënligjor, formën dhe vlefshmërinë e certifikatës së kualifikimit të këshilltarëve të sigurisë në paragrafin 3. të nenit 29 të këtij ligji, kushtet që duhet të plotësojnë institucionet që kryejnë procesin e trajnimit të këshilltarëve, përmbajtjen dhe mënyrën e kryerjes së provimeve, listën e lëndëve ose çështjeve që duhet të trajtohen dhe përbërjen e komisionit të caktuar për kryerjen e provimit. Tarifatat për trajnimin dhe, ose provimin e këshilltarëve të sigurisë përcaktohen nga Ministria me akt nënligjor në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për financa.
3. Komisioni i provimit të përmendur në paragrafin 2, të këtij neni, në fillim të çdo viti kalendarik emërohet nga Ministri me propozim të Komisioni sipas paragrafit 1. të nenit 54 të këtij ligji.
4. Për punën e kryer sipas paragrafit 1. të këtij neni, anëtarët e komisionit shpërblehen sipas mënyrës dhe vlerave të përcaktuara me vendim të Qeverisë.
5. Trajnimi profesional i personave të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni mund të kryhet nga personi juridik i autorizuar nga Ministria, nëse ato plotësojnë kushtet e vendosura në aktin nënligjor të përmendur në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 33

Edukimi profesional i personave të përfshirë në transport

1. Personat e punësuar nga pjesëmarrësit, të përmendur në nenin 14 të këtij ligji, detyrimet e të cilëve lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme, të kenë përfunduar programin e trajnimit profesional, në varësi të detyrave dhe përgjegjësi të pozicionit, dhe të kenë kaluar provimin e edukimit profesional.
2. Edukimi profesional i personave sipas paragrafit 1. të këtij neni, si dhe shtrirja e njohurive të tyre për sigurinë e operacioneve të rëndësishme që ata kryejnë, duhet të jetë periodik në raste të parashikuara, me qëllim rifreskimin e njohurive, dhe kontrollet ndaj tyre të jenë të paparalajmëruara. Dokumentacioni mbi trajnimin e çdo punonjësi mbahet nga punëdhënësi në dosjen personale të çdo punëmarrësi, si dhe nga vetë punëmarrësi.
3. Trajnimi profesional i personave të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni mund të kryhet nga personi juridik i autorizuar nga Ministria nëse ata plotësojnë kushtet e vendosura, për këtë qëllim. Certifikatat e trajnimit para lëshimit duhet të regjistrohen.
4. Provimi për aftësimin profesional të personave sipas paragrafit 1. të këtij neni kryhet nga institucionet e përmendura në paragrafin 3. të këtij neni.
5. Programi, zbatimi, edukimi profesional dhe mënyra e organizimit të provimit përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë.
6. Forma, përmbajtja, mënyra dhe procedura për lëshimin e certifikatave për personat që kanë dhënë provimin të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, si dhe kushtet që duhet të përmbushen nga organet sipas paragrafit 3. të këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë.
7. Tarifat për trajnimin dhe, ose provimin e pjesëmarrësve në transport përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për financa.
8. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për personelin e punësuar sipas paragrafit 1. të këtij neni kur transporti është i përjashtuar nga dispozitat sipas marrëveshjes të nenit 5 të këtij ligji.

KREU IV

DISPOZITAT TË VEÇANTA PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME ME RRUGË

Neni 34

Detyrimet e transportuesit

1. Transportuesi duhet të plotësojë kushtet e nenit 13 të këtij ligji, për mjetin i cili përdoret për transportin e mallrave të rrezikshme.
2. Për transportin e mallrave të rrezikshme, transportuesi lejon vetëm drejtues mjeti të kualifikuar për transportin e mallrave rrezikshme në përputhje me nenin 39 të këtij ligji.

Neni 35

Detyrimet e dërguesit

1. Dërguesi i mallrave të rrezikshme me rrugë, përveç detyrimeve të paraqitura në nenin 15 të këtij ligji, duhet të plotësoj edhe detyrimet e mëposhtme:

1.1. të informoj transportuesin mbi panelet dhe shenjat që duhet të vendosen mbi mjet
1.2. të informoj transportuesin mbi mallrat e rrezikshme
1.3. shenjzimin e paketave me shenjat paralajmëruese, mbishkrimet dhe etiketat me shenjat e rrezikut; dhe

1.4. të plotësoj kërkesa të tjera për transportin në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në

paragrafin 1. të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 36

Kushtet dhe detyrimet e drejtuesit të mjetit

1. Drejtuesi i mjetit duhet të ushtroj detyrën e tij si drejtues i një mjeti që transporton mallra të rrezikshme, në qoftë se:

1.1. ka mbushur moshën njëzet e një (21) vjeç dhe të ketë drejtuar, të paktën një (1) vit, një mjet me masë maksimale që i kalon 3.5 tonë
1.2. është i pajisur me certifikatën e kualifikimit në përputhje me dispozitat e marrëveshjes sipas paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji
1.3. merr përsipër obligimet e tij dhe të gjithë detajet e operacionit të transportit
1.4. mjeti, mallrat e rrezikshme dhe ngarkesa plotësojnë standardet e kërkuara në dispozitat e marrëveshjes sipas paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji;

etiketat me shenjën e rrezikut, dhe është i pajisur me informacione të tjera në lidhje me mallrat e rrezikshme dhe mjetet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes sipas paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji
1.6. zotëron dokumente dhe pajisje në përputhje me dispozitat e marrëveshjes sipas paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji
1.7. ka plotësuar kërkesat e tjera për transportin në përputhje me dispozitat e marrëveshjes sipas paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për drejtuesin e një mjeti kur janë në përputhje me dispozitat përjashtuese në marrëveshjen e paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 37

Masat e sigurisë

1. Drejtuesi i mjetit gjatë ngarkimit, shkarkimit dhe transportit të mallrave të rrezikshme duhet të zbatoj masat e sigurisë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes sipas paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji.

2. Drejtuesi i mjetit, gjatë transportit duhet të jetë në përputhje me dispozitat e marrëveshjes sipas paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji dhe me rregullat e përmendura në paragrafin 3. dhe 4. të këtij neni.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet e transportit në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për çështjet e brendshme dhe Ministrinë përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së mjedisit me akt nënligjor, përcaktojnë vendet e parkimit për mjetet e transportit të mallrave të rrezikshme dhe kushtet që duhet të përmbushin këto vende.

4. Ministria përgjegjëse për çështjet e transportit në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për çështjet e brendshme dhe Ministrinë përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së mjedisit, me akt nënligjor, vendosin kufizime për transportin e mallrave të rrezikshme në rrugët publike.

Neni 38

Inspektimi i mjetit

1. Konformiteti i mjeteve për transportin e mallrave të rrezikshme, të caktuar sipas nenit 13 të këtij ligji, është subjekt i një certifikate të konformitetit ose, siç do të quhet më poshtë, certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme, të caktuar, e cila lëshohet nga personi juridik i autorizuar nga Ministria.

2. Personi juridik i përmendur në paragrafin 1. të këtij neni kryen inspektimin e mjeteve, përpunimin e dokumenteve dhe lëshimin e certifikatës së miratimit për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme të caktuar, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në paragrafin 1. të nenit 5 të këtij ligji.

3. Inspektimi i mjetit për qëllime të përpunimit të dokumentacionit mbi bazën e të cilës lëshohet certifikata e miratimit për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme, të caktuar sipas paragrafit 1. të këtij neni, kryhet nga inspektuesit e kontrollit teknik, të cilët zotërojnë të paktën diplomën universitare të inxhinierisë mekanike, që kanë kompetencat e personit juridik të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni.

4. Përpunimi i dokumentacionit mbi bazën e të cilës lëshohet certifikata e miratimit për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme, të caktuar, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të kryhet nga persona që kanë përfunduar përgatitjen e mesme shkollore drejtimi i makinerisë ose komunikacion.

5. Procedura dhe vendet për inspektimin e mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme, si dhe lëshimi i certifikatës së konformitetit të mjetit për transportin mallrave të rrezikshme, të caktuar, në përputhje me marrëveshjet e përmendur në nenin 5 të këtij ligji, si dhe kushtet që duhen të plotësohen nga personi juridik i përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

6. Tarifat për inspektimin e mjetit për transportin e mallrave të rrezikshme, përcaktohen me akt

nënligjor nga Ministria në bashkëpunim me Ministrinë për financa.

Neni 39

Trajnimi profesional i drejtuesve të mjeteve

1. Drejtuesit e mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme duhet të jenë të pajisur me një certifikatë të vlefshme kualifikimi.
2. Certifikata e kualifikimit lëshohet pasi drejtuesi i mjetit i është nënshtruar një kursi trajnimi dhe pasi ka kaluar një provim mbi kërkesat e veçanta që duhet të plotësohen gjatë transportit të mallrave të rrezikshme. Trajnimi dhe testimi (kontrolli) i drejtuesve të mjeteve kryhet nga personi juridik i autorizuar nga Ministri, nëse ato plotësojnë kushtet sipas paragrafit 5. të këtij neni.
3. Programi, zbatimi, metoda e trajnimit, metoda e testimit të aftësisë profesionale të drejtuesve dhe kushtet për akreditimin e institucioneve që kryejnë procesin e trajnimit të drejtuesve në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.
4. Forma, përmbajtja dhe vlefshmëria e certifikatave, mënyra dhe procedura për lëshimin e certifikatave të drejtuesit e testuar, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në paragrafin 1. të nenit 5 të këtij ligji, kushtet që duhet të plotësohen nga institucionet e paragrafin 2. të këtij neni përcaktohen me akt nën ligjor nga Ministria.
5. Institucionet e autorizuar sipas paragrafit 2. të këtij neni do të mbajnë në regjistër, çdo kurs trajnimi të miratuar, çdo person të trajnuar dhe të testuar, si dhe çdo certifikatë kualifikimi të lëshuar, për një periudhë e cila përcaktohet me akt nën ligjor nga Ministria.

Neni 40

Kontrolli në rrugë

1. Shërbimet e kontrollit në rrugë të mallrave të rrezikshme kryhet nga personat e autorizuar të organeve të kontrollit në rrugë, policia e trafikut dhe inspektorati i Ministrisë së Infrastrukturës. Nëse gjatë ushtrimit të detyrës kërkohen njohuri specifike, shërbimet e kontrollit në rrugë përfshin inspektorët e mbrojtjes së mjedisit dhe inspektorët tjerë, dhe kur është e nevojshme dhe kur nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi, mund të merren organizata ose individë të specializuar.
2. Gjatë ushtrimit të kontrollit, personat e autorizuar për kontroll, kur është e përshtatshme dhe me kusht që të mos përbëj rrezik për sigurinë, mund të marrin mostra të mallrave të rrezikshme që transportohen për t'i ekzaminuar, ose klasifikuar, ose për kërkime në zhvillimin e teknologjisë, për kontrollin e cilësisë ose si mostra për tregti në laboratorët e akredituar. Mostrat e marra nuk kompensohen.
3. Kontrollat në rrugë janë të rastësishme e duhet të shtrihen në pjesën më të madhe të rrjetit rrugor.
4. Me kërkesën e personave të autorizuar për kontroll, drejtuesi i mjetit është i detyruar, pa vonesë, të paraqesë dokumentacionin në lidhje me mjetin e mallrat e rrezikshme që transporton, si dhe çdo dokument tjetër ose informacion që i

kërkohet për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji.

5. Përmbajtja dhe forma e procesverbalit për mostra të mallrave të rrezikshme në paragrafin 2. të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor të Ministrisë.

6. Personi i autorizuar për kontroll, pas kryerjes së kontrollit, jep një kopje të dokumentit të kontrollit drejtuesit të mjetit, i cili e paraqet atë sa herë kërkohet për kontrole të mëtejshme nga personat e autorizuar. Përmbajtja dhe forma e dokumentit të kontrollit përcaktohet me akt nënligjor të Ministrisë.

7. Nëse personi i autorizuar për kontroll gjykon të arsyeshme se mjete ka nevojë për një inspektim ose ekzaminim të mëtejshëm, ai shoqëron mjetin në një vend të sigurt e të përshtatshëm, të caktuar nga ai, ku riparohen defektet e identifikuar, që mund të sjellin rrezik të sigurisë. Në këtë rast, udhëtimi i mjetit lejohet të kryhet në rrugë sa më të pështashme për mënjanimin e cenimit të sigurisë në rrugë, dhe shpenzimet janë të pronarit ose drejtuesit të mjetit.

Neni 41

Ndalimi i përkohshëm ose ndalimi i operacioneve të transportit

1. Nëse personi i autorizuar për kontroll konstaton se ka ndodhur një shkelje e rregullave të qarkullimit e specifikuar në listën që parashikon paragrafi 3. i nenit 46 të këtij ligji, mund të pezulloj operimin e mëtejshëm të transportit dhe merr masa për eliminimin e të metave, ose zbaton masat të tjera të përcaktuara. Të eliminoj të metat në vend, nëse ato nuk përbëjnë rrezik për sigurinë e njerëzve, pronës dhe mjedisit. Personi i autorizuar për kontroll vendos masën e dënimit në vend, pasi ka sqaruar drejtuesin për shkeljen e konstatuar dhe drejtuesi është i detyruar të eliminoj të metat dhe pastaj mund të vazhdoj udhëtimin.

2. Gjatë ndalimit të përkohshëm të transportit, mjete mund të lëvizë i drejtuar vetëm nga personi i autorizuar për kontroll. Në rastin e një shkelje të mundshme të dispozitave të ndalimit të transportit ose masave të vendosura, personi i autorizuar për kontroll ka të drejtë të ndaloj vazhdimin e operacionit të transportit në mënyrë që të largoj mjetin nga trafiku, dhe për llogari të transportuesit, vendos ose parkon mjetin në një vend të përshtatshëm e të sigurt.

3. Nëse mjete pëson dëmtime nga një aksident, personi i autorizuar për kontroll, pas kryerjes së investigimit, tërheq certifikatën e miratimit për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme, të caktuar në nenin 13 të këtij ligji dhe i dorëzon certifikatën personit juridik të autorizuar që e ka lëshuar, si dhe njofton ministrinë.

4. Nëse një organ tjetër gjatë vëzhgimit të mallrave të rrezikshme ka konstatuar mangësi që mund të rrezikojnë sigurinë e njerëzve, pronës dhe mjedisit, njofton organet e shërbimit të kontrollit në rrugë dhe jep informacion rreth mjetit dhe mallrave të rrezikshme.

Neni 42

Kontrollet në mjediset e ndërmarrjes

1. Personat e autorizuar për kontroll në bashkëpunim me inspektorët e mbrojtjes së mjedisit dhe inspektorët tjerë kryejnë kontrole në mjediset e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në transportin e mallrave të rrezikshme, bëjnë inspektime, konsultojnë dokumentet e nevojshme dhe marrin mostra të mallrave të rrezikshme ose të ambalazhit të tyre për ekzaminim në laboratorët e akredituar, me qëllim marrjen e masave parandaluese në transportin e mallrave të rrezikshme.
2. Kontrollet në mjediset e ndërmarrjes kryhen në rastet kur janë:
 - 2.1. të programuara; ose
 - 2.2. të detyrueshme, si një masë parandaluese kur shkeljet, të cilat rrezikojnë sigurinë e njerëzve, pronës dhe mjedisit, janë regjistruar si të përsëritura gjatë kontrolleve në anë të rrugës.
3. Nëse personat e autorizuar për kontroll vërejnë se dispozitat e marrëveshjeve sipas nenit 5 të këtij ligji nuk plotësohen, ato ose ndërpresin operacionet e transportit deri sa mangësitë dhe, ose defektet të eliminoj, ose mund të ndalojnë dërgesën.

Neni 43

Mbikëqyrja e dërguesit, transportuesit ose marrësit

1. Një person i autorizuar për kontrollin në rrugë nëse gjatë kontrollit në rrugë identifikon mangësi, kryen, gjithashtu, mbikëqyrjen e dërguesit, transportuesit ose marrësit të mallrave të rrezikshme ose të personave juridik ose fizik të tjerë pjesëmarrës, të përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme.
2. Personat juridik ose fizikë janë të detyruar të lejojnë personin e autorizuar për inspektimin e mjetit, përshtatshmërinë e procedurave dhe njohjen me dokumentet në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme.
3. Qëllimi i kontrollit sipas paragrafit 1. të këtij neni është përcaktimi i kushteve të sigurisë në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme nga persona juridikë ose fizikë, si dërguesi, transportuesi ose marrësi i mallrave të rrezikshme ose nga personat juridikë ose fizikë, të tjerë, pjesëmarrës në transportin e mallrave të rrezikshme.
4. Kur gjatë kontrollit sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni konstatohen një ose më shumë shkelje në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme, të metat e identifikuar në transportin e pranishëm duhet të eliminoj para se mjeti të lerë vendin, ku ai është ndaluar për t'u mbikëqyrur.

Neni 44

Hyrja e mjeteve të huaja në territorin e Republikës së Kosovës

1. Personi i autorizuar për kontroll në pikat e kalimit të kufirit ndalojnë hyrjen në territorin e Republikës së Kosovës të një mjete të regjistruar në një shtet tjetër, nëse konstaton shkelje sipas listës në paragrafin 3. të nenit 46 të këtij ligji, si dhe merr masat të tjera të përshtatshme. Hyrja në territorin e Republikës së Kosovës do të lejohet vetëm nëse të metat e konstatuara evitohen.

2. Personi i autorizuar për kontrollin në rrugë përjashton nga trafiku mjetet sipas paragrafit 1. të këtij neni dhe vepron në përputhje me masat e parashikuara në paragrafin 1. të nenit 45 të këtij ligji.

Neni 45

Asistenca reciproke

1. Ministria shkëmben informacion me autoritetin kompetent të Shtetit, ku mjete është i regjistruar, nëse gjatë kontrollit vëren se siguria në transportin e mallrave të rrezikshme është kompromentuar si rezultat i shkeljeve serioze ose të përsëritura të dispozitave të marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji.

2. Nëse autoriteti kompetent i një shteti tjetër kërkon të filloj procedurat kundër transportuesit të regjistruar në Republikën e Kosovës, ose nëse kërkon informacion të nevojshëm për sqarimin e rrethanave të shkeljeve të marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji, në shtetin tjetër, ose fillon procedurat kundër transportuesit me seli/rezident në Republikën e Kosovës, Ministria përcakton masat në zbatim të këtij ligji.

3. Ministria informon autoritetin kompetent të shtetit tjetër për masat e marra sipas paragrafit 2. të këtij neni.

Neni 46

Raporti vjetor

1. Organet e kontrollit, të cilat kryejnë kontrole në zbatim të këtij ligji, i dorëzojnë ministrisë një raport vjetor, mbi kontrollet të kryera për vitin paraprak deri në fund të muajit prill të vitit në vazhdim.

2. Raporti përmban:

2.1. sasinë e përcaktuar apo të vlerësuar të mallrave të rrezikshme të transportuara, nëse është e mundur në tonë të transportuara ose në tonë/kilometra
2.2. numrin e kontroleve të kryera
2.3. numrin e mjeteve të kontrolluara, i klasifikuar sipas shtetit të regjistrimit të mjetit
2.4. numrin dhe llojet e shkeljeve të regjistruara, në përputhje me kategorinë e rrezikut
2.5. numrin dhe llojet e masave ndëshkuese të vendosura.

3. Hartimi i listës së shkeljeve të përcaktuara në marrëveshjen sipas paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji të grupuara sipas kategorive të rrezikut me veprimet e duhura të organeve përgjegjëse dhe përshkrimi i përmbajtjes së raportit vjetor caktohen me akt nënligjor të Ministrisë.

4. Ministria mbështetur mbi të dhënat harton një raport të përmbledhur vjetor, të cilin ia dërgon organeve përgjegjëse ndërkombëtare.

KREU V

DISPOZITAT E VEÇANTA PËR TRANSPORTIN HEKURUDHUR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME

Neni 47

Llojet e trenave të lejuar, transporti i mallrave të rrezikshme si bagazh dore, bagazhet e kontrolluar apo mjetet e ngarkuar në tren

1. Mallrat e rrezikshme mund të transportohen vetëm me anën e trenave të mallrave, me përjashtim të:

1.1. mallrave të rrezikshme të pranuar për transport sipas marrëveshjes të paragrafit 2. të nenit 5 të këtij ligji, e cila përmban sasinë maksimale të lejuar dhe kushtet e veçanta të transportit në trena të ndryshëm nga trenat e mallrave

1.2. mallrave të rrezikshme që transportohen në përputhje me kushtet të veçanta sipas marrëveshjes së paragrafit 2. të nenit 5 të këtij ligji, si bagazh dore ose si bagazh.

2. Kur mallrat e rrezikshme mbarten me mjete të ngarkuar në tren, ato duhet të plotësojnë kushtet:

2.1. mjetet dhe përmbajtja e tyre të ngarkuar në tren duhet të përputhet me dispozitat e marrëveshjes së paragrafit 1. të nenit 5 të këtij ligji

2.2. transporti i tyre me tren ndalohet, nëse parashikohet në dispozitat e marrëveshjes të paragrafit 2. të nenit 5 të këtij ligji.

3. Cilido që udhëton me tren nuk duhet të marrë me vete mallra të rrezikshme në bagazhin e dorës, ose t'i dorëzojë ato si bagazh, ose në mjetin e ngarkuar në tren, nëse nuk plotësohen kushtet e marrëveshjes së paragrafit 2. të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 48

Detyrimet e dërguesit

1. Dërguesi dorëzon mallrat e rrezikshme për transport hekurudhor, nëse plotësohen kërkesat e nenit 15 të këtij ligji, dhe nëse:

1.1. transportuesi paraqitet me shenjat që duhet të mbartin mjetet dhe të dhënat për mallrat e rrezikshme

1.2. në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së përmendur në paragrafin 2. të nenit 5 të këtij ligji në mjetet dhe pakot vendosen shenjat e paralajmërimit, mbishkrimet, shenjat dhe etiketat për shenjëzimin e rrezikut, ose, nëse për këtë qëllim, dorëzohen së bashku me mallrat e rrezikshme.

Neni 49

Detyrimet e mbushësit

1. Përveç detyrimeve në nenin 20 të këtij ligji, mbushësi i mallrave të rrezikshme ka për detyrë të kontrolloj:

1.1. afatin e kontrollit të ardhshëm për cisternat-vagon, cisternave me bateri –vagon, cisternave të çmontueshme ose portative, i cili nuk duhet të ketë kaluar; dhe

1.2. çdo gjë tjetër para dhe pas mbushjes së cisternave të gazit të lëngshëm.

Neni 50

Detyrimet e transportuesit

Përveç detyrimeve në nenin 16 të këtij ligji, transportuesi gjatë transportit duhet shpejtë dhe pa kufizim të verë në dispozicion të administruesit të infrastrukturës rrugore informacione në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme në përputhje me dispozitat e marrëveshjes sipas paragrafit 2. të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 51

Detyrimet e administruesit të infrastrukturës hekurudhore

1. Administruesi i infrastrukturës hekurudhore duhet të:

1.1. përgatisë plane për emergjencën e brendshme për stacionet hekurudhore në përputhje me marrëveshjen e paragrafit 2. të nenit 5 të këtij ligji
1.2. të sigurohet që të ketë në çdo moment një qasje të menjëhershme e pa kufizim për informacionet vijuese:

1.2.1. plan formimin e trenave duke treguar numrin dhe kategorinë e vagonëve të ngarkuar me mallra të rrezikshme dhe pozicionin e tyre në tren; dhe

1.2.2. numrin e UN të mallrave të rrezikshme të transportuara në vagonët.

1.3. mënyrat e transmetimit të këtyre të dhënave përcaktohen në rregulloret e përdorimit të infrastrukturës hekurudhore.

2. Të dhënat e përmendura në nënparagrafin 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni do të jenë në dispozicion vetëm për ato shërbime ose agjenci, të cilat kanë kërkesa të njëjta e të nevojshme në lidhje me sigurinë ose ndërhyrjen e shërbimeve emergjente.

KREU VI

KOMPETENCAT E INSPEKTIMIT DHE ORGANET TRJERA MBIKËQYRËSE

Neni 52

Mbikëqyrja mbi zbatimin e ligjit

Mbikëqyrja administrative dhe inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara për zbatimin e këtij ligji, kryhet nga ministria përgjegjëse për transport, ministria përgjegjëse për çështjet e brendshme, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, Agjensioni për Mbrojtje nga rrezatimi dhe Siguria bërthamore.

Neni 53

Mbikëqyrja e inspektimi

1. Kontrolli për implementimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për transportin e substancave radioaktive dhe materialeve bërthamore kryhet nga Inspektorati i Ministrisë së Shëndetësisë.
2. Në kryerjen e kontroleve të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, inspektori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
 - 2.1. të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të marrëveshjes sipas nenit 5 të këtij ligji në rast të ndonjë aksidenti ose incidenti gjatë transportit ose gjatë kalimit transit përmes territorit të Republikës së Kosovës
 - 2.2. të mbikëqyrë përgatitjen për ambalazhimin (paketimin), ngarkimin, shkarkimin dhe transportin, dhe nëse konstaton parregullsi, ai urdhëron eliminimin brenda një afati të caktuar, ose ndalon përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë në rastin e shkeljeve serioze;
 - 2.3. të ndalojë vazhdimin e operacionit nëse konstaton që nuk ka autorizim dhe dokumentacionin e parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, nëse transporti nuk monitorohet nga shoqërues të trajnuar ose nëse operacioni i transportit ka dështuar në zbatim të masave të sigurisë
 - 2.4. të kontrollojë dokumentet për transportin, etiketimin e pajisjeve të mjeteve, itinerarin e udhëtimit, të vendosur për eliminimin e parregullsive, ose, kur, gjatë kontrollit të personave, mjeteve dhe burimeve të ndriçimit identifikon parregullsi, ndalon vazhdimin e operacionit për shmangien e dëmtimeve në njerëz dhe mjedis.
3. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, në lidhje me transportin e substancave ose artikujve eksplozivë, kryhet nga ministria për çështjet e brendshme.
4. Kur mallrat e rrezikshme hynë në ose nga pikat e kalimit të kufirit të Republikës së Kosovës, procedurat për miratimin e lejimit dhe përdorimit të mallrave të rrezikshme, që i përkasin mbikëqyrjes në zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme, kryhen nga organet doganore në pikën e kalimit të kufirit, në këtë rast përgjegjësia është e administratës së organeve doganore.
5. Monitorimi në zbatim të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme në rrugë kryhet nga organet përgjegjëse për

kontrollin në transportin rrugor, me përjashtim të dispozitave që lidhen me kushtet e prodhimit dhe testimit të ambalazhit.

6. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme me hekurudhë, kryhet nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave.

Neni 54

Komisioni ndërministror për transportin e mallrave të rrezikshme

1. Për qëllime të efektivitetit në zbatimin e këtij ligji, menaxhimin e mallrave të rrezikshme dhe rritjen në një nivel të konsiderueshëm të koordinimit ndërministror për transportin e mallrave të rrezikshme, Qeveria emëron Komisionin ndërministror për transportin e mallrave të rrezikshme, i cili përbëhet nga dhjetë deri pesëmbëdhjetë (10-15) anëtarë.
2. Në përbërje të Komisionit sipas paragrafit 1., Ministri, Ministri i brendshëm, Ministri i forcës së sigurisë, Ministri i shëndetësisë, Ministri e planifikimi hapësinor dhe mjedisit, dhe Ministri i zhvillimit ekonomik, propozojnë nga (2) dy anëtarë. Qëllimi, detyrat dhe çdo hollësi tjetër përkatëse, që lidhet me funksionimin e këtij Komisioni, caktohen me vendim të Qeverisë.
3. Kryetar i komisionit caktohet zëvendësministri përgjegjës për transport.
4. Komisioni ka të drejtë të emëroj ekspertë të tjerë në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme.
5. Ministri cakton një sekretari që siguron mbarëvajtjen e punës së komisionit, e cila përbëhet nga katër (4) anëtarë, të drejtorive që mbulojnë operimin, sigurinë dhe shërbimet e kontrollit në rrugë, në transportin me rrugë dhe një anëtar që mbulon fushën e transportit hekurudhor.

Neni 55

Ruajta e regjistrimeve

1. Për sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme në përputhje me kërkesat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe zbatimit të këtij ligji, Ministria mban të dhënat për drejtuesit e mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme me rrugë.
2. Për sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme në përputhje me kërkesat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe zbatimit të këtij ligji, ministria mban të dhënat për këshilltarët e sigurisë të emëruar nga personat fizikë e juridikë.
3. Regjistri mbi dënimet e drejtuesve të mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme përfshin të dhënat:
 - 3.1. numrin e dënimeve
 - 3.2. datën e lëshimit të certifikatës
 - 3.3. emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes, drejtuesit të cilit i është lëshuar certifikata
 - 3.4. vlefshmërinë e trajnimit bazë dhe lloji i vlefshmërisë për çdo trajnim të specializuar
 - 3.5. datën e

përfundimit pas zgjatjes së trajnimit bazë dhe llojin dhe datën e vlefshmërisë për çdo trajnim të specializuar.

4. Regjistri i personit juridik ose fizik të cilët kanë të emëruar këshilltarë sigurisë, përfshin:

4.1. emrin e personit juridik ose fizik 4.2. vendqëndrimin/selinë e personit juridike 4.3. emrin dhe mbiemrin e këshilltarit të sigurisë 4.4. datën e informimit për emërimin si këshilltar.

Neni 56

Mbledhja e të dhënave

1. Të dhënat mbi zbatimin e trajnimit dhe zbatimin e ekzaminimit profesional të drejtuesve të mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme me rrugë, organet e autorizuar për kryerjen e trajnimit dhe vlerësimit profesional të drejtuesve janë të detyruar t'i paraqesin në ministri brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e përfundimit të provimeve profesionale të drejtuesve të mjeteve.
2. Të dhënat mbi personin juridik dhe fizik të cilët janë emëruar si këshilltar të sigurisë mblidhen mbi bazë të kërkesës për informim për personin juridik ose fizik në ministri në bazë të paragrafit 2. të nenit 29 të këtij ligji.
3. Ministria mbi baza të ekzaminimit të këshilltarëve krijon dhe menaxhon regjistrin kryesor.
4. Personi i cili administron mbledhjen e të dhënave, i dorëzon, me kërkesë të organit përgjegjës për mbikëqyrje, të dhënat e përmendura në nenin 55 të këtij ligji, në pajtueshmëri me këtë ligj.
5. Për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, shpërndarjen dhe përdorimin e të dhënave nga regjistrat e përmendur në nenin 55 të këtij ligji zbatohen dispozitat e ligjit i cili rregullon mbrojtjen e të dhënave personale, nëse në këtë ligj nuk parashikohet ndryshe.

Neni 57

Kontrolli i brendshëm

Transportuesi, që kryejnë veprimtari në transportin tokësor të mallrave të rrezikshme e që kanë të punësuar mbi njëzet (20) punonjës, realizojnë kontrollin e tyre të brendshëm për zbatimin e rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij, nëpërmjet organizmave të tyre të kontrollit, sipas detyrave të përcaktuara në aktet themeluese, në statute, dhe në rregulloret e tyre të brendshme.

KREU VII DISPOZITAT MBI SANKSIONET

Neni 58

Gjobat

1. Personi juridik për kundërvajtje gjobitet dyqind (200) deri në një mijë (1.000) euro, nëse:

1.1. nëse miraton shënime (etiketa) të ambalazhit në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjeve në nenin 5 të këtij ligji. 1.2. një pako ose mjet, i cili nuk përdoret për transportin e mallrave të rrezikshme sipas nenit 28 të këtij ligji, është shënuar me shenja paralajmëruese ose me etiketa të mallrave të rrezikshme.

2. Personi juridik për kundërvajtje gjobitet një mijë (1.000) deri në pesë mijë (5.000) euro, nëse:

2.1. dërgon mallra të rrezikshme të ambalazuara (paketuara) me ambalazh që nuk i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji

2.2. transporton mallra të rrezikshme të ambalazuara (paketuara) në ambalazh që nuk i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji

2.3. merr në dorëzim mallra të rrezikshme të ambalazuara (paketuara) në ambalazh që nuk i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji

2.4. prodhuesi i ambalazhit vepron në kundërshtim me nenin 9 të këtij ligji

2.5. përdor një mjet që nuk është i prodhuar dhe i pajisur në përputhje me nenin 13 të këtij ligji

2.6. përdor një mjet që nuk është i kontrolluar dhe nuk është i pajisur me certifikatë sipas nenit 13 të këtij ligji

2.7. dërguesi vepron në kundërshtim me nenin 15 të këtij ligji, para transportimit të mallrave të rrezikshme të këtij ligji

2.8. dërguesi nuk ka dorëzuar dokumentet mbështetëse të parashikuar dhe autorizimin drejtuesit të mjetit ose personit që kryhen transportin në përputhje me nenin 15 të këtij ligji

2.9. Cisterna – kontejner ose cisterna e lëvizshme nuk është në përputhje me nenin 21 të këtij ligji

2.10. transporton mallra në kundërshtim me nenin 16 të këtij ligji

2.11. pranon mallrat e rrezikshme në kundërshtim me nenin 17 të këtij ligji

2.12. gjatë transportit nuk kontraktton persona të autorizuar për grumbullimin, heqjen ose vendosjen në një vend të caktuar në përputhje me paragrafin 2. të nenit 23 të këtij ligji

2.13 kryen transport mallrash të rrezikshme pa autorizim ose në kundërshtim me kushtet që janë vendosur në autorizim për kryerjen e operacioneve të transportit sipas neneve 24 dhe 26 të këtij ligji

2.14. kryen transport të mallrave të rrezikshme, pavarësisht ndalimit ose dështimit në plotësimin e kushteve të veçanta në transportin e mallrave të rrezikshme, të vendosura nga organi përgjegjës në nenin 27 të këtij ligji

2.15. Këshilltari i sigurisë nuk plotëson kushtet e përcaktuara sipas nenit 29 të këtij ligji

2.16. Këshilltari i sigurisë nuk plotëson detyrimet e nenit 30 të këtij ligji

2.17. personi ose personat pjesëmarrës në transportin e mallrave të rrezikshme nuk janë të kualifikuar në përputhje me nenin 33 të këtij ligji

2.18. dështon në sigurimin e kushteve për transportin e mallrave të rrezikshme në përputhje me nenin 34 të këtij ligji;

2.19. nuk vepron në përputhje me nenin 35 të këtij ligji

2.20. lejon një person të pakualifikuar ose që zotëron një certifikatë të pavlefshme kualifikimi, të drejtoj një mjet në transportin e mallrave të rrezikshme në kundërshtim me dispozitat e neneve 36 dhe 39 të këtij ligji

2.21. nuk është në përputhje me paragrafin 1., 2., 3. dhe 4. të nenit 38 të këtij ligji

2.22. nuk i ofron organit përgjegjës për kontrollin pasqyrën e dokumenteve shoqëruese ose nuk arrin t'i japë një pasqyrë të pajisjeve shtesë ose mallrave të rrezikshme ose kur merret një sasi e nevojshme për analizë e mallrave të rrezikshme dhe nuk kujdeset për kryerjen e një kontrolli në vend ose në një vend të përcaktuar sipas nenit 40 të këtij ligji

2.23. nuk lejon zbatimin e procedurave të kontrollit për inspektimin e mjetit dhe gjithë dokumentacionit në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme në përputhje me paragrafin 1. dhe 2. të nenit 43 të këtij ligji

2.24. vepron pavarësisht ndalimit sipas paragrafit 4. të nenit 43 të këtij ligji dhe disa veprimeve të caktuara që ka për të kryer

2.25. transporton mallra në kundërshtim me nenin 47 të këtij ligji

2.26. nuk vepron në përputhje me nenin 50 të këtij ligji

2.27. administruesi i infrastrukturës hekurudhore kur nuk vepron në përputhje me paragrafin 1. dhe 2. të nenit 51 të këtij ligji

2.28. para fillimit të transportit të mallrave të rrezikshme me hekurudhë nuk plotëson detyrimet sipas nenit 48 të këtij ligji

2.29. nuk jep informacion në lidhje me trajnimin e drejtuesve të mjeteve dhe këshilltarëve të sigurisë sipas paragrafit 1. dhe 2. të nenit 55 të këtij ligji

3. Personi juridik për kundërvajtje gjobitet pesë mijë (5.000) deri në dhjetë mijë (10.000) euro, nëse:

3.1. nuk informon për humbjen e mallrave të rrezikshme Qendrën për Alarmim dhe Koordinim Emergjent të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent 112 sipas nenit 22 të këtij ligji

3.2. nuk merr masat e duhura në rast derdhje ose rrjedhje të mallrave të rrezikshme duke i grumbulluar, hequr, ose vendosur në një vend të caktuar në përputhje me paragrafin 1. të nenit 23

3.3. nuk ka emëruar një këshilltar të sigurisë ose nuk japin të dhënat apo ndonjë ndryshim të mundshëm të tij në institucionet përgjegjëse dhe personave juridikë në përputhje me nenin 29 ose 53 të këtij ligji

3.4. vazhdon operacionin e transportit kur është marrë një masë pezullimi ose ndalimi sipas nenit 41 të këtij ligji.

4. Personi fizik për kundërvajtje gjobitet dyqind (200) deri në një mijë (1.000) euro, nëse:

4.1. malli nuk është në përputhje me rregullat mbi paketimin, etiketat, shënimet mbi rreziqet dhe masat e tjera të sigurisë në përputhje me dispozitat e nenit 19 të këtij ligji

4.2. mbushësi para gjatë ngarkimit nuk përmbush rregullat e sigurisë në përputhje me dispozitat e paragrafit 1. të nenit 20 të këtij ligji

4.3. ngarkuesi nuk kryhen detyrat në përputhje me nenin 18 të këtij ligji

4.4. marrësi nuk kryhen detyrat në përputhje me nenin 17 të këtij ligji;

4.5. Këshilltari i sigurisë, nuk është i kualifikuar ose nuk zotëron një certifikatë të vlefshme të kualifikimit në përputhje me paragrafin 3. të nenit 29 të këtij ligji

4.6. Këshilltari i sigurisë nuk kryhen detyrat e përcaktuara në nenin 30 të këtij ligji

4.7. personi i përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme, nuk është i kualifikuar sipas paragrafit 1. dhe 2. të nenit 33 të këtij ligji

4.8. drejtuesi i mjetit, nuk plotëson kushtet e nenit 36 të këtij ligji për transportin e mallrave të rrezikshme

4.9. drejtuesi i mjetit, nuk vepron në përputhje me dispozitat e nenit 37 të këtij ligji

4.10. drejtuesi i mjetit, nuk është i pajisur me certifikatë të kualifikimit profesional sipas paragrafit 1, të nenit 39 të këtij ligji

4.11. drejtuesi i mjetit me kërkesë të personit të autorizuar për kontroll nuk plotëson detyrimet e përcaktuara në dispozitat e paragrafit 4., 5., 6. dhe 7. të nenit 40 të këtij ligji

4.12. drejtuesi i mjetit nuk vepron në përputhje me dispozitat e paragrafit 1. dhe 2. të nenit 41 të këtij ligji

4.13. udhëtari nuk vepron në përputhje me dispozitat e nenit 47 të këtij ligji

4.14. mbushësi nuk vepron në përputhje me dispozitat e nenin 49 të këtij ligji.

KREU VIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 59

Marrëveshjet bilaterale ose shumëpalëshe

Ministri, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes në nenin 5 të këtij ligji, mund të nënshkruaj marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me autoritetet kompetente të shteteve, Palë Kontraktuese, për lejimin e transportuesve me seli në shtetet me të cilët ka një marrëveshje të tillë në fuqi, për kryerjen e disa operacioneve të përkohshme të transportit ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme, me kusht që siguria në transport të mos cenohet.

Neni 60

Përkthimi dhe publikimi i marrëveshjeve

1. Ministri përgjegjës për çështjet e transportit autorizon përkthimin në gjuhën shqipe dhe publikimin e marrëveshjeve sipas paragrafit 1. dhe 2. të nenit 5 të këtij ligji, “Marrëveshja Evropiane mbi transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë” (ADR) dhe Rregullores për transportin hekurudhor ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme (RID).

2. Përkthimi dhe publikimi i marrëveshjeve sipas paragrafit 1. të këtij neni do të kryhet periodikisht sa herë rishqyrtohen e ribotohen anekset A dhe B, për transportin me rrugë dhe Aneksi C, për transportin hekurudhor.

Neni 61

Hartimi i akteve nënligjore në përputhje me Direktivat e BE

1. Ministria, në bashkëpunim ose jo, me Ministrinë tjera përkatëse, sipas rastit, nxjerrin akte nënligjore me qëllim përafrimin dhe përditësimin e legjislacionit të transportit të mallrave të rrezikshme me direktivat e rregulloret e Komunitetit Evropian, si dhe me marrëveshjet sipas nenit 5 të këtij ligji.

2. Rregulloret dhe direktivat e Legjislacionit të Bashkimit Evropian nëse i zëvendësojmë rregulloret dhe direktivat në të cilat bazohet ky ligj do të ketë fuqinë ligjore për sektorin e transportit të mallrave të rrezikshme.

Neni 62

Te hyrat

Të ardhurat e krijuara nga tarifat e mbledhura dhe dënimet e vendosura sipas këtij Ligji derdhen në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Neni 63

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ministria për implementimin e dispozitave të këtij ligji nxjerr akte përkatëse nënligjore në afat prej gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi.

Neni 64

Dispozitat përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 2004/6 për Transportin e mallrave të rrezikshme. (Gazeta Zyrtare e Republikës të Kosovës /Prishtinë Nr. 22/01 mars.2008 si dhe të gjitha dispozitat tjera që bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 65

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-183

19 mars 2013

Shpallur me dekretin Nr.DL-010-2013, datë 05.04.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.